



Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt

Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾

Përmbledhja MujorePër sinjaliziminTë Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 27 qershor 2025



LajmetOperacionet

27/06/2025

Tiranë/Finalizohet Operacioni I Koduar “Gold”

Tiranë

Finalizohet operacioni i koduar “Gold”, për parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit ndërmjet 2 shtetasve.

Goditi me thikë një 38-vjeçar dhe më pas fshehu një armë zjarri kallashnikov që e mbante në banesë, pa leje, kapet dhe vihet në pranga 45-vjeçari.

Gjenden dhe sekuestrohen arma e zjarrit dhe mjeti prerës (thikë).

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, pas marrjes së njoftimit se në Rrugën e Kavajës, po konfliktoheshin 2 shtetas, kanë organizuar punën për parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit. Në kuadër të operacionit të koduar “Gold”, u arrestua në flagrancë shtetasi:

F. G., 45 vjeç, banues në Tiranë.

Ky shtetas dyshohet se është konfliktuar me shtetasin N. M., 38 vjeç, dhe e ka goditur atë, me mjet prerës (thikë), për motive të dobëta. 38-vjeçari mori ndihmën mjekësore në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Më pas, shtetasi F. G. ka marrë në banesën e tij, një armë zjarri kallashnikov që e posedonte pa leje dhe e ka fshehur në rrugën “Mujo Ulqinaku”, bashkë me thikën me të cilën ka kryer plagosjen.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Vlorë/Goditet një rast i shitjes së lëndëve të forta narkotike, në qytetin e Vlorës

DVP Korçë/Transportonte 8 emigrantë nga Vendet e Treta, shpallet në kërkim 26-vjeçari ▶